



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGIJË
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 22 mars 2024
Kodi i ZRRE-së: V_1876_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, Nenit 15 dhe Nenit 26 paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Dispozitat e Nenit 8, paragrafët 1 dhe 6, të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e nenit 15 dhe nenit 26 paragrafi 1, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Dispozitat e Rregullës dhe Metodologjinë për Përgatitjen e Bilanceve të Energjisë Nr. 03/2020 (e nxjerrë në qershor 2020); dhe
- Kërkesën e bërë me datë 04 dhjetor 2023 nga përfaqësues të ndërmarrjes publike “**NGROHTORJA E QYTETIT SH.A**”, me adresë Rruga Tirana p.n., Gjakovë, Republika e Kosovës, për miratimin e dokumentit “Bilanci Vjetor i Energjisë Termike për vitin 2024”.

në seancën e mbajtur më 22 mars 2024 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET “Bilanci vjetor i energjisë termike për vitin 2024” i ndërmarrjes “NGROHTORJA E QYTETIT SH.A”.**
- II. Obligohet i licencuari që pas pranimit të këtij Vendimi ta publikojë dokumentin “Bilanci Vjetor i Energjisë Termike - 2024” në faqen elektronike zyrtare të tij.**

A R S Y E T I M

- Ndërmarrja “**NGROHTORJA E QYTETIT SH.A**”. (në vijim N.Q.) si bartëse e Licencës për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë termike, bazuar në dispozitat ligjore të legjislationit në fuqi ka përgatitur dokumentin “Bilanci Vjetor i Energjisë Termike për vitin 2024”. Në përputhje me procedurat ligjore dhe rregullative, drafti parë i këtij dokumenti është dorëzuar me 04 dhjetor 2023 për shqyrtim në ZRRE dhe në Ministrinë e Ekonomisë. Pas shqyrtimit dhe komentimit të këtij drafti nga këto dy institucione, me 22 dhjetor 2023 është dorëzuar drafti i përmirësuar sipas komenteve, i cili është konsideruar i finalizuar për tu paraqitur para Bordit të ZRRE-së për miratim.
- Pas shqyrtimit të draft-dokumentit “Bilanci Vjetor i Energjisë Termike - 2024” të dorëzuar nga NP Ngrohtorja e Qytetit Gjakovë sh.a. dhe përmirësimit e plotësimit të tij sipas komenteve të ME-së dhe ZRRE-së, Bordi i ZRRE-së duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



3. Duke pasur parasysh ndikimin e parametrave të ndryshëm të bilancit në përcaktimin e tarifave, Rregullatori mban të drejtën që gjatë shqyrtimit tariforë të përshtatë të dhënat që përmban Bilanci vjetor i energjisë termike.
4. Bazuar në dispozitat e Nenit 42 paragrafit 2.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Rregullatori monitoron implementimin e Bilancit Vjetor të Energjisë Termike për të verifikuar realizimin e të dhënave dhe informatave të paraqitura në këtë Bilanc dhe mund të ndërmarr veprime specifike për promovimin dhe përmirësimin e sigurisë afatshkurtër dhe afatgjatë të furnizimit me energji.

III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodhë e fundit.

Bashkëngjitur:

“Bilanci Vjetor i Energjisë Termike – 2024”

Vendimi ju dërgohet:

- Ndërmarrjes “NGROHTORJA E QYTETIT SH.A” dhe
- Arkivit të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Qorolli, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar